



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 3778 prot.

Tiranë, më 10 06 2024

URDHËR

Nr. 370, datë 10.06 2024

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 432, DATË 30.06.2023 TË MINISTRIT TË DREJTËSISË “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR ORGANIZIMIN, ZHVILLIMIN, PËRMBAJTJEN E PROVIMIT TË PRANIMIT, SI DHE PROCEDURËN E VLERËSIMIT DHE SHPALLJES SË REZULTATEVE PËR PËRMBARUESIN GJYQËSOR SHTETËROR”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; si dhe të nenit 17, pika 5, të ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”,

URDHËROJ:

Neni 1

1. Në pikën 1 të nenit 4, togfjalëshi “*brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e publikimit të thirrjes*” zëvendësohet me “*brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e publikimit të thirrjes*”.

Neni 2

Në nenin 5 bëhen ndryshimet si vijon:

1. Në pikën 2, togfjalëshi “*brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit*” zëvendësohet me “*brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit*”.
2. Në pikën 3, togfjalëshi “*brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit*” zëvendësohet me “*brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit*”.
3. Në pikën 4, togfjalëshi “*brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i procedurës*” zëvendësohet me “*brenda 3 (tri) ditëve nga përfundimi i procedurës*”.

Neni 3

Neni 6 ndryshohet si vijon:

1. Në pikën 1, togfjalëshi “jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë” zëvendësohet me “jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë”.
2. Në pikën 3, togfjalëshi “jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë” zëvendësohet me “jo më vonë se 5 (pesë) ditë”.

Neni 4

Në pikën 1 të nenit 19, togfjalëshi “jo më vonë se 2 (dy) javë” zëvendësohet me “jo më vonë se 1 (një) javë”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR


Ulsi Manja

